



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 12, Datë 08.04.2014

PËR

**MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE TË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN
“KOMPLEKS INDUSTRIAL PËR PRODHIM ARTIZANAL KËPUCËSH, SHOWROOM
DHE ZYRA”, BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të neneve 6, 8 dhe 70/5 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore të Ndërtimit për objektin “Kompleks industrial për prodhim artizanal këpucësh, showroom dhe zyra” në Bashkinë Durrës, me kërkues shoqërinë “ENDI” Sh.p.k.
2. Harta e planvendosjes së strukturës bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Formulari i Lejes Zhvillimore të Ndërtimit i jepet subjektit kërkues pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.
4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI



MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT




Z. ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT